

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 210

RËNIA DAKORD ME KUSHTET E ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Hyrja në fuqi	2
Objektivat	3
Përkufizimet	4-5
Kërkesat	
Parakushtet për një Auditim	6-8
Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit	9-12
Auditimet e Njëpasnjëshme	13
Pranimi i një Ndryshimi në Kushtet e Angazhimit të Auditimit	14-17
Konsiderata Shtesë në Pranimin e Angazhimit	18-21
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Objekti i këtij SNA-je	A1
Parakushtet për një Auditim	A2-A21
Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit	A22-A29
Auditimet e Njëpasnjëshme	A30
Pranimi i një Ndryshimi në Kushtet e Angazhimit të Auditimit	A31-A35
Konsiderata Shtesë në Pranimin e Angazhimit	A36- A39
Shtojcë 1: Shembull i një Letre të Angazhimit të Auditimit	
Shtojcë 2: Përcaktimi i Pranueshmërisë së Kuadrove për Qëllime të Përgjithshme	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 210, “Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtëm me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA), trajton përgjegjësitë e audituesit në rënien dakord mbi kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin dhe, kur është e përshtatshme, me personat e ngarkuar me qeverisjen. Kjo përfshin përcaktimin e ekzistencës së parakushteve të caktuara për një auditim, përgjegjësia për të cilat bie mbi drejtimin dhe, kur është e përshtatshme, mbi personat e ngarkuar me qeverisjen. SNA220¹ trajton ato aspekte të pranimit të angazhimit që janë në kontrollin e audituesit. (Ref: Para. A1)

Hyrja në fuqi

2. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivat

3. Objektivi i audituesit është që të pranojë ose të vazhdojë një angazhim të auditimit vetëm kur baza mbi të cilin ai angazhim duhet të kryhet është rënë dakord, nëpërmjet:
 - a) Vendosijes nëse parakushtet për një auditim janë të pranishme; dhe
 - b) Konfirmimit se ekziston një mirëkuptim i përbashkët mes audituesit dhe drejtimin dhe, kur është e përshtatshme, personave të ngarkuar me qeverisjen mbikushtet e angazhimit të auditimit.

Përkufizimet

4. Për qëllime të SNA-ve, termii mëposhtëm ka kuptimin që i është dhënë në vijim:

Parakushtet për një auditim - Përdorimi nga drejtimi i një kuadri të pranueshëm të raportimit financiar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe pranimit nga drejtimi, dhe atje ku është e përshtatshme, nga personat e ngarkuar me qeverisjen, i përgjegjës² mbi përgatitjen e pasqyrave mbi të cilat është kryer auditimi.

¹SNA220, *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*.

²SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 13.

5. Për qëllime të këtij SNA-je, referencat për "drejtimin" në tekstin e mëposhtëm do të lexohen si "drejtimi dhe, ku është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen".

6. Kërkesat

Parakushtet për një Auditim

7. Për të përcaktuar nëse parakushtet për një auditim janë të pranishme, audituesi duhet të:
 - (a) Përcaktojë nëse kuadri i raportimit financiar që do të aplikohet në përgatitjen e pasqyrave financiare është i pranueshëm; dhe (Ref: Para. A2-A10)
 - (b) Marrë miratimin që ai (drejtimi) i njeh dhe i kupton përgjegjësitë e veta. (Ref: Para. A11-A14, A21)
 - i. Për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, duke përfshirë ku është e nevojshme paraqitjen e tyre të drejtë; (Ref: Para. A15)
 - ii. Për kontrole të brendshme që përcaktohen si të nevojshme nga ana e drejtimit për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimeve apo mashtrimit; dhe (Ref: Para. A16-A19)
 - iii. Për t'i ofruar audituesit:
 - a. Akses në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni dhe që janë të rëndësishme për përgatitjen e pasqyrave financiare të tilla si të dhëna, dokumente dhe çështje të tjera;
 - b. Informacione shtesë që audituesi mund të kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
 - c. Akses të pakufizuar mbi persona brenda subjektit, që audituesi i përcakton si të nevojshëm për të siguruar evidenca auditimi.

Kufizimi në Qëllim Para Pranimit të Angazhimit të Auditimit

8. Nëse drejtimi apo personat e ngarkuar me qeverisjen imponojnë një kufizim të qëllimit të punës së audituesit, nëpërmjet kushteve të një angazhimi auditimi të propozuar, në nivel të tillë që audituesi beson se ky kufizim do të rezultojë në mohim të dhënies së opinionit mbi pasqyrat financiare, audituesi

nuk duhet të pranojë të tilla angazhime të kufizuara si një angazhim auditimi, përveç rasteve kur kërkohet me ligj ose rregullore për ta bërë një gjë të tillë.

Faktorë të Tjerë që Ndikojnë në Pranimin e Angazhimit të Auditimit

9. Në qoftë se parakushtet për një auditim nuk janë të pranishme, audituesi duhet ta diskutojë çështjen me drejtimin. Përveç rasteve kur kërkohet me ligj ose rregullore për të bërë një gjë të tillë, audituesi nuk e pranon angazhimin e auditimit të propozuar:
 - a) nëse audituesi ka konstatuar se kuadri i raportimit financiar që zbatohet në përgatitjen e pasqyrave financiare është i papranueshëm, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 19; ose
 - b) në qoftë se marrëveshja e përmendur në paragrafin 6(b) nuk është arritur.

Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit

10. Audituesi bie dakord për kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin apo me personat e ngarkuar me qeverisjen, sipas rastit. (Ref: Para. A22)
11. Në varësi të paragrafit 11, kushtet e rëna dakord të angazhimit të auditimit regjistrohen në një letër angazhimi auditimi, apo forma të tjera marrëveshjeje të përshtatshme të shkruara, dhe përfshijnë: (Ref: Para. A23-A27)
 - (a) Objektivin dhe qëllimin e auditimit të pasqyrave financiare;
 - (b) Përgjegjësitë e audituesit;
 - (c) Përgjegjësitë e drejtimit;
 - (d) Identifikimin e kuadrit të raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare, dhe
 - (e) Referenca për formën dhe përmbajtjen e pritshme të çdo raporti që do të lëshohet nga audituesi; dhe (Ref: Para. A24)
 - (f) Një pasqyrë që mund të ketë rrethana në të cilat një raport mund të ndryshojë nga forma dhe përmbajtja e tij e pritshme.
12. Në qoftë se ligji ose rregulloret parashikojnë në detaje të mjaftueshme kushtet e angazhimit të auditimit të referuara në paragrafin 10, audituesi nuk ka nevojë të hedhë këto të dhëna në një marrëveshje me shkrim, me përjashtim të faktit që ky ligj apo rregullore zbatohet dhe se drejtimi i pranon dhe i kupton

përgjegjësitë e tij siç është përcaktuar në paragrafin 6(b). (Ref: Para. A23, A28-A29)

13. Në qoftë se ligji ose rregulloret përcaktojnë përgjegjësitë drejtimit të ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 6 (b), audituesi mund të vlerësojë që ligji ose rregulloret përfshijnë përgjegjësi, që sipas gjykimit të audituesit, janë efektivisht të barazvlefshme me ato të përcaktuara në atë paragraf. Për përgjegjësi të tilla që janë të barazvlefshme, audituesi mund të përdorë formulimin e ligjit ose rregulloreve në formulimin e marrëveshjeve me shkrim. Për ato përgjegjësi që nuk janë parashikuar në ligj ose rregullore në mënyrë të tilla që efekti i tyre është i barabartë, marrëveshja e shkruar përdor përshkrimin në paragrafin 6(b). (Ref: Para. A28)

Auditimet e Njëpasnjëshme

14. Në auditimet e njëpasnjëshme, audituesi duhet të vlerësojë nëse rrethanat e kërkojnë që të rishikohen kushtet e angazhimit të auditimit dhe nëse është e nevojshme që entitetit t'i kujtohen edhe një herë kushtet ekzistuese të angazhimit të auditimit. (Ref: Para.A30)

Pranimi i një Ndryshimi në Kushtet e Angazhimit të Auditimit

15. Audituesi nuk duhet të bjerë dakord për një ndryshim në kushtet e angazhimit të auditimit kur nuk ka justifikime të arsyeshme për të vepruar kështu. (Ref: Para. A31-A33)
16. Nëse para përfundimit të angazhimit të auditimit audituesi i kërkohet të ndryshojë angazhimin e auditimit në një angazhim që përcjell një nivel më të ulët sigurie, audituesi duhet të përcaktojë nëse ekziston një justifikim i pranueshëm për të vepruar kështu. (Ref: Para. A34-A35)
17. Në qoftë se kushtet e angazhimit të auditimit ndryshojnë, audituesi dhe drejtimi bien dakord mbi kushtet e reja të angazhimit nëpërmjet një letre angazhimi apo formë tjetër të përshtatshme marrëveshjeje të shkruar.
18. Nëse audituesi nuk bie dakord për një ndryshim të kushteve të angazhimit të auditimit dhe nuk lejohet nga drejtimi për të vazhduar auditimin fillestar, audituesi duhet të:
 - (a) Tërhiqet nga angazhimi i auditimit aty ku është e mundur në bazë të ligjeve ose rregulloreve të zbatueshme; dhe
 - (b) Përcaktojë nëse ka ndonjë detyrim kontraktual apo të ndonjë forme tjetër, për të raportuar këto rrethana ndaj palëve të tjera, të tillë si personat e ngarkuar me qeverisjen, pronarët apo entet rregullatore.

Konsiderata Shtesë në Pranimin e Angazhimit*Standardet e Raportimit Financiar të Plotësuara nga Ligji apo Rregulloret*

19. Në qoftë se standardeve të raportimit financiar, të përcaktuara nga një organizatë e autorizuar ose e pranuar për vendosjen e standardeve, u shtohen ligje apo rregullore, audituesi duhet të përcaktojë nëse ka ndonjë konflikt mes standardeve të raportimit financiar dhe kërkesave shtesë. Në qoftë se konflikte të tilla ekzistojnë, audituesi duhet të diskutojë me drejtimin natyrën e kërkesave shtesë dhe të bjerë dakord nëse:

- (a) Kërkesat shtesë mund të plotësohen përmes shënimeve shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare; ose
- (b) Përshkrimi i kuadrit të raportimit financiar në pasqyrat financiare mund të ndryshohet në përputhje me rrethanat.

Nëse asnjë nga veprimet e mësipërme s'është i mundur, audituesi duhet të përcaktojë nëse është e nevojshme për të modifikuar opinionin e audituesit në pajtueshmëri me SNA 705.³ (Ref:Para. A36)

Kuadri i Raportimit Financiar i përcaktuar me Ligj ose Rregullore - Çështje të tjera që ndikojnë në Pranimin e Angazhimit

20. Nëse audituesi konstaton se kuadri i raportimit financiar i përshkruar me ligj ose rregullore do të ishte i papranueshëm, por duke qenë se është i parashikuar me ligj ose rregullore, audituesi duhet ta pranojë angazhimin e auditimit vetëm nëse kushtet e mëposhtme janë të pranishme: (Ref:Para. A37)

- (a) Drejtimi pranon të japë informacion shtesë në pasqyrat financiare për të shmangur ndonjë keqkuptim lidhur me to; dhe
- (b) Është pranuar në kushtet e angazhimit të auditimit që:
 - i. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare do të përfshijë një paragraf që thekson Çështjen, i cili tërheq vëmendjen e përdoruesve mbi shënimet shpjeguese shtesë, në pajtueshmëri me SNA 706 (i rishikuar);⁴ dhe
 - ii. Opinioni i audituesit mbi pasqyrat financiare nuk do të përfshijë fraza të tilla si "paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale,"

³SNA705, *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur.*

⁴SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafi i Theksimit të Çështjes dhe Paragrafët e Çështjeve të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur.*

ose "japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë" në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, përveç rasteve kur audituesit i kërkohet me ligj ose rregullore për të shprehur opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare duke përdorur fraza të tilla.

21. Në qoftë se kushtet e përsëhruara në paragrafin 19 nuk janë të pranishme dhe është e nevojshme me ligj ose rregullore që audituesi të ndërmarrë angazhimin e auditimit, audituesi duhet të:
- a) Vlerësojë efektin çorientues të pasqyrave financiare mbi raportin e audituesit; dhe
 - b) Përfshijë referencat e përshtatshme për këtë çështje në kushtet e angazhimit të auditimit.

Raporti i Audituesit i Përcaktuar me Ligj ose Rregullore

22. Në disa raste, ligji apo rregulloret e juridiksionit përkatës përsëhruan formatin apo tekstin e raportit të audituesit në një formë ose në kushte që janë dukshëm të ndryshme nga kërkesat e SNA-ve. Në këto rrethana, audituesi duhet të vlerësojë:

- (a) Nëse përdoruesit mund të keqkuptojnë sigurinë e marrë nga auditimi i pasqyrave financiare dhe, nëse po,
- (b) Nëse shpjegime shtesë në raportin e audituesit mund të zvogëlojnë mundësinë për keqkuptime të mundshme.⁵

Nëse audituesi konkludon që shpjegimet shtesë në raportin e audituesit nuk mund të zvogëlojnë mundësinë për keqkuptime të mundshme, audituesi nuk duhet të pranojë angazhimin e auditimit, përveç nëse kërkohet me ligj ose rregullore për ta bërë këtë. Një auditim i kryer në pajtim me këto ligje ose rregullore nuk është në përputhje me SNA-të. Prandaj, audituesi nuk duhet të përfshijë asnjë referencë në raportin e audituesit që auditimi është kryer në përputhje me SNA-të.⁶(Ref: Para. A38-A39)

⁵SNA706 (i rishikuar)

⁶Shiko gjithashtu SNA700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafi 43.

Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese

Objektii këtij SNA-je(Ref: Para. 1)

- A1. Angazhimet e dhënies së sigurisë, të cilat përfshijnë angazhimet e auditimit, mund të pranohen vetëm kur profesionisti mendon se kërkesat përkatëse etike të tilla si pavarësia dhe kompetenca profesionale do të mund të plotësohen dhe kur angazhimi paraqet disa karakteristika të caktuara.⁷ Përgjegjësitë e audituesit në respektimin e kërkesave etike në kontekstin e pranimit të një angazhimi auditimi për aq sa ato janë nën kontrollin e audituesit trajtohen në SNA 220.⁸ Ky SNA merret me ato çështje (apo parakushte) që janë në kontrollin e entitetit dhe mbi të cilat është e nevojshme të bihet dakort mes audituesit dhe drejtimit të entitetit.

Parakushtet për një Auditim

Kuadri i raportimit financiar (Ref:Para 6 (a))

- A2. Një kusht për pranimin e një angazhimi për dhënien e sigurisë është që kriteret e përmendura në përkufizimin e një angazhimi të dhënies së sigurisë janë të përshtatshme dhe në dispozicion për përdoruesit e synuar.⁹ Kriteret janë standardet që përdoren për të vlerësuar apo për të matur çështjen kryesore, duke përfshirë, sipas rastit, standardet për prezantim dhe paraqitje. Kriteret e përshtatshme bëjnë të mundur një vlerësim apo matje të arsyeshme dhe të qëndrueshme të një çështjeje brenda kontekstit të gjykimit profesional. Për qëllime të SNA-ve,kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar parashikon kriteret që audituesi përdor për auditimin e pasqyrave financiare, duke përfshirë paraqitjen e tyre të drejtë kur kjo është e nevojshme.
- A3. Pa një kuadër të pranueshëm të raportimit financiar, drejtimi nuk ka një bazë të përshtatshme për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe audituesi nuk ka kriteret të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare. Në shumë raste audituesi mund të supozojë se kuadri i raportimit financiar në fuqi është i pranueshëm, siç përshkruhet në paragrafët A8-A9.

⁷Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Dhënies së Sigurisë, paragrafi17.

⁸SNA220, paragrafët 9-11.

⁹Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Dhënies së Sigurisë, paragrafi17(b)(iii).

Përcaktimi i Pranueshmërisë së Kuadrinë Raportimit Financiar

- A4. Faktorët që janë të nevojshëm në përcaktimin e audituesit në lidhje me pranueshmërinë e kuadrin të raportimit financiar që duhet të zbatohet në përgatitjen e pasqyrave financiare përfshijnë:
- Natyrën e entitetit (për shembull, nëse ajo është një sipërmarrje biznesi, entitet i sektorit publik apo një organizatë jo-fitimprurëse);
 - Qëllimi i pasqyrave financiare (për shembull, nëse ato janë përgatitur për të përmbushur nevojat për informacion financiar të një game të gjerë përdoruesish apo nevojat për informacion financiar të përdoruesve të veçantë);
 - Natyra e pasqyrave financiare (për shembull, nëse pasqyrat financiare janë një grup i plotë pasqyrash financiare apo një pasqyrë financiare e vetme); dhe
 - Nëse ligji ose rregulloret përcaktojnë kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
- A5. Shumë përdorues të pasqyrave financiare nuk janë në pozitë për të kërkuar pasqyra financiare të përshtatura për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion. Ndërkohëqë nuk mund të plotësohen të gjitha nevojat për informacion të përdoruesve të veçantë, ka nevoja për informacion financiar që janë të përbashkëta për një gamë të gjerë përdoruesish. Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të raportimit financiar që synon të përmbushë nevojat e përbashkëta për informacion financiar të një game të gjerë përdoruesish janë të referuara si pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme.
- A6. Në disa raste, pasqyrat financiare do të përgatiten në përputhje me një kuadër raportimi financiar që synon të përmbushë nevojat për informacion financiar të përdoruesve të veçantë. Këto pasqyra financiare janë të referuara si pasqyra financiare me qëllim të posaçëm. Në këto rrethana, nevojat e përdoruesve për informacionin financiar do të përcaktojnë kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. SNA 800 diskuton pranueshmërinë e kuadrin të raportimit financiar që synon të përmbushjen e nevojave për informacion financiar të përdoruesve të veçantë.¹⁰
- A7. Pasi pranohet angazhimi i auditimit, mund të ndeshen mangësi të kuadrin të zbatueshëm të raportimit financiar që tregojnë se ky kuadër nuk është i pranueshëm. Kur përdorimi i atij kuadri është i përcaktuar me ligj apo

¹⁰SNA 800 (i rishikuar), *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare Përgatitura në Përputhje me një Kuadër të Veçantë*, paragrafi 8.

rregullore, zbatohen kërkesat e paragrafëve 19-20. Kur përdorimi i këtij kuadri nuk është i parashikuar me ligj ose rregullore, drejtimi mund të vendosë për të miratuar një kuadër tjetër që është i pranueshëm. Kur drejtimi e bën këtë, siç kërkohet nga paragrafi 16, vendosen kushte të reja të angazhimit të auditimit për të pasqyruar ndryshimin në kuadër, pasi kushtet e pranuar më parë nuk do të jenë më të sakta.

Kuadrot për qëllime të përgjithshme

- A8. Aktualisht, nuk ka bazë objektive dhe autoritare të njohur globalisht për të gjykuar pranueshmërinë e kadrove për qëllime të përgjithshme. Në mungesë të një baze të tillë, standardet e raportimit financiar të vendosura nga organizatat që janë të autorizuar ose të njohura për të shpallur standarde të cilat përdoren nga disa lloje të caktuara entitetesh supozohet të jenë të pranueshme për pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të përgatitura nga entitete të tilla, me kusht që organizatat të ndjekin një proces të vendosur dhe transparent që përfshin reflektimin dhe marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të një game të gjerë palësh të interesuara.

Shembuj të këtyre standardeve të raportimit financiar përfshijnë:

- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të shpallura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) të shpallura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; dhe
- Parimet e Kontabilitetit shpallur nga një organizatë e autorizuar ose e njohur në vendosjen e standardeve në një juridiksion të veçantë, me kusht që organizata të ndjekë një proces themelimi transparent që përfshin pasqyrimin dhe marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të një game të gjerë palësh të interesuara.

Këto standarde të raportimit financiar janë identifikuar shpesh si kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar sipas ligjeve ose rregulloreve që rregullojnë përgatitjen e pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm.

Kuadrot e raportimit financiar të parashikuar me ligj ose rregullore

- A9. Në përputhje me paragrafin 6 (a), është e nevojshme që audituesi të përcaktojë nëse kuadri i raportimit financiar, që zbatohet në përgatitjen e pasqyrave financiare, është i pranueshëm. Në disa juridiksione, ligji ose rregulloret mund të sugjerojnë kuadrin e raportimit financiar që do të përdoret në përgatitjen e pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm për lloje të caktuara

entitetesh. Në mungesë të të dhënave që tregojnë të kundërtën, një kuadër i tillë raportimi financiar, supozohet si i përshtatshëm për pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm të përgatitura nga këto entitete. Në rast se kuadri nuk konsiderohet të jetë i pranueshëm, do të zbatohen paragrafët 19-20.

Juridiksione që nuk kanë organizata të përcaktimit të standardeve apo kuadër të sugjeruar të raportimit financiar

- A10. Nëse një njësi ekonomike është e regjistruar apo vepron në një juridiksion që nuk ka një organizatë të autorizuar ose të njohur për vendosjen e standardeve, apo ku përdorimi i kuadrit të raportimit financiar nuk është i parashikuar me ligj ose rregullore, drejtimi identifikon një kuadër të raportimit financiar për të zbatuar në përgatitjen e pasqyrave financiare. Shtojca 2 përmban udhëzime për përcaktimin e pranueshmërisë së kuadrit të raportimit financiar në rrethana të tilla.

Marrëveshje të Përgjegjësive të Drejtimit (Ref: Para. 6(b))

- A11. Auditimi në përputhje me SNA-të kryhet duke u bazuar në parakushtin që drejtimi ka pranuar dhe kupton përgjegjësitë e përcaktuara në paragrafin 6(b).¹¹ Në disa juridiksione, përgjegjësi të tilla mund të jenë të përcaktuara në ligj ose rregullore. Në të tjera, mund të ketë pak ose aspak përkufizime ligjore apo rregullore të këtyre përgjegjësive. SNA-të nuk mbivendosen ndaj ligjit ose rregulloreve në çështje të tilla. Megjithatë, koncepti i një auditimi të pavarur kërkon që roli i audituesit të mos përfshijë mbajtjen e përgjegjësive për përgatitjen e pasqyrave financiare apo kontrollet e brendshme përkatëse të entitetit dhe që audituesi ka një pritshmëri të arsyeshme për marrjen e informacionit të nevojshëm për auditimin (përfshirë informacionin e siguruar nga jashtë librave kontabël të përgjithshëm dhe ndihmës) për atë kohë sa drejtimi është në gjendje ta ofrojë ose sigurojë atë. Për këtë arsye, parakushti është thelbësor për kryerjen e një auditimi të pavarur. Për të shmangur keqkuptimet, arrihet një marrëveshje me drejtimin ku ai pranon dhe kupton që ka përgjegjësi të tilla si pjesë e rënies dakord dhe regjistrimit të kushteve të angazhimit të auditimit në paragrafët 9-12.
- A12. Mënyra në të cilën përgjegjësitë për raportimin financiar janë të ndara ndërmjet drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen do të ndryshojë në varësi të burimeve dhe strukturës së entitetit dhe çdo ligji ose rregulloreje përkatëse, dhe roleve përkatëse të drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen brenda entitetit. Në shumicën e rasteve, drejtimi është përgjegjës për ekzekutimin ndërsa personat e ngarkuar me qeverisjen për mbikëqyrjen e drejtimit. Në disa raste, personat e ngarkuar me qeverisjen do të kenë, apo do të marrin, përgjegjësinë për të miratuar pasqyrat financiare apo për të monitoruar kontrollet e brendshme të entitetit në lidhje me raportimin

¹¹SNA200, paragrafi A4.

financiar. Në entitete të mëdha apo ato publike, një nën grup i personave të ngarkuar me qeverisjen, si për shembull komiteti i auditimit, mund të jetë i ngarkuar me mbikëqyrjen e disa përgjegjësiëve.

- A13. SNA 580 kërkon që audituesi t'i kërkojë drejtimin deklarime me shkrim për faktin që ai (drejtimi) ka përmbushur disa nga përgjegjësitë e tij.¹² Për pasojë, mund të jetë i përshtatshëm ndërgjegjësimi i drejtimin për pritshmërinë e marrjes së këtyre deklarimeve me shkrim, së bashku me deklarimet me shkrim të kërkuara nga SNA-të e tjera dhe, kur është e nevojshme, deklarimeve me shkrim për të mbështetur evidencën tjetër të auditimit që ka të bëjë me pasqyrat financiare ose me një apo më shumë pohime të veçanta në pasqyrat financiare.
- A14. Kur drejtimi nuk do të pranojë përgjegjësitë e tij, ose të bjerë dakord për të dhënë deklarimet me shkrim, audituesi nuk do të jetë në gjendje të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme.¹³ Në rrethana të tilla, nuk do ishte e përshtatshme për audituesin që të pranojë angazhimin e auditimit, përveç rastit kur kjo i kërkohet audituesit nga ndonjë ligj ose rregullore. Në rastet kur audituesiti kërkohet të pranojë angazhimin e auditimit, audituesit mund t'i lindë nevojatë për shpjegojë drejtimin rëndësinë e këtyre çështjeve, si dhe implikimet në raportin e audituesit.

Përgatitja e Pasqyrave Financiare (Ref:Para. 6(b)(i))

- A15. Shumica e kuadrove të raportimit financiar përfshijnë kërkesa në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare; për kuadro të tillë, *përgatitja* e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e raportimit financiar përfshin *paraqitjen*. Në rastin e një kuadri të paraqitjeve të drejtë rëndësia e objektivitetit të raportimit për paraqitjen e drejtë është e tillë që parakushti i rënë dakord me drejtimin përfshin referim të veçantë ndaj paraqitjes së drejtë, ose ndaj përgjegjësisë për të siguruar që pasqyrat financiare do të "japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë" në përputhje me kuadrin e raportimit financiar.

Kontrolli i Brendshëm (Ref:Para. 6(b)(ii))

- A16. Drejtimi mban kontrole të brendshme të tilla që ai i ka përcaktuar si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Kontrolli i brendshëm, pavarësisht efektivitetit, mund t'i sigurojë një entiteti vetëm siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave të raportimit financiar në sajë të kufizimeve të pashmangshme të kontroleve të brendshme.¹⁴

¹²SNA580, *Deklarimet me Shkrim*, paragrafët 10-11.

¹³SNA580, paragrafi A26.

¹⁴SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*, paragrafi A54.

- A17. Një auditim i pavarur i kryer sipas SNA-ve nuk është një zëvendësues për mbajtjen e kontrollit të brendshëm të nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare nga drejtimi. Për këtë arsye, audituesi ti kërkohet që të marrë aprovim nga drejtimi që ai pranon dhe kupton përgjegjësinë e tij për kontrollin e brendshëm. Megjithatë, marrëveshja e kërkuar nga paragrafi 6(b)(ii) nuk nën kupton që audituesi do të gjejë që kontrolli i brendshëm që mbahet nga drejtimi ka arritur objektivin e tij apo është pa mangësi.
- A18. Është detyrë e drejtimit për të përcaktuar se çfarë kontrolli i brendshëm është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare. Termi "kontrolli brendshëm" përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve brenda kompanisë që mund të përkruhen si mjedisi i kontrollit; procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit; sistemi i informacionit, duke përfshirë edhe proceset përkatëse të biznesit që kanë të bëjnë me raportimin financiar dhe komunikimin; veprimtaritë e kontrollit; dhe monitorimin e kontrolleve. Megjithatë, kjo ndarje, nuk pasqyron domosdoshmërisht se si një entitet i veçantë mund të projektojë, zbatojë dhe mbajë kontrollin e brendshëm, ose se si ai mund të klasifikojë ndonjë komponent të veçantë.¹⁵ Kontrolli i brendshëm i një entiteti (veçanërisht, librat dhe regjistrimet kontabël, apo sistemet e kontabilitetit) do të reflektojnë nevojat e drejtimit, kompleksitetin e biznesit, natyrën e rreziqeve me të cilat përballet entiteti, dhe ligjet ose rregulloret përkatëse.
- A19. Në disa juridiksione, ligjore rregulloret mund ti referohen përgjegjësisë së drejtimit për përshtatshmërinë e librave dhe regjistrimeve kontabël, ose sistemeve të kontabilitetit. Në disa raste, praktika e përgjithshme mund të supozojë një dallim midis librave dhe regjistrimeve kontabël apo sistemeve të kontabilitetit nga njëra anë dhe kontrollit ose kontrolleve të brendshme nga ana tjetër. Duke qënë se librat dhe regjistrimet kontabël, ose sistemet e kontabilitetit, janë pjesë përbërëse e kontrollit të brendshëm siç përcaktohet në paragrafin A18, një përcaktim i tillë nuk bëhet në paragrafin 6 (b)(ii) lidhur me përshtatshmërinë e përgjegjësisë së drejtimit. Për të shmangur keqkuptimet, mund të jetë e përshtatshme që audituesi t'i shpjegojë drejtimit qëllimin e kësaj përgjegjësie.

Informacion shtesë (Ref: Para. 6(b)(iii)b)

- A20. Informacioni shtesë që audituesi mund të kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit, mund të përfshijë, kur kjo është e zbatueshme, çështjet që lidhen me informacionet e tjera sipas SNA 720 (i rishikuar). Kur audituesi parashikon të sigurojë informacione të tjera pas datës së raportit të audituesit, kushtet e angazhimit të auditimit mund të parashikojnë edhe përgjegjësitë e audituesit në lidhje me këto informacione të tjera, përfshirë kur është rasti, veprimet që

¹⁵SNA 315 (i rishikuar), paragrafi A59 dhe Shtojca 1.

mund të jenë të përshtatshme ose të nevojshme, nëse audituesi arrin në përfundimin se ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, të marra pas datës së raportit të audituesit.

Konsideratat në Lidhje me Entitetet e Vogla (Ref: Para. 6(b))

A21. Një nga qëllimet për rënien dakord lidhur me kushtet e angazhimit të auditimit është shmangia e keqkuptimeve mbi përgjegjësitë respektivisht të drejtimit dhe audituesit. Për shembull, kur një palë e tretë ka asistuar në përgatitjen e pasqyrave financiare, mund të jetë e nevojshme që t'i kujtohet drejtimit se përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar mbetet përgjegjësi e tij.

Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit

Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit (Ref: Para. 9)

A22. Rolet e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në rënien dakord me kushtet e angazhimit të auditimit për entitetin varet nga struktura qeverisëse e entitetit dhe ligjet ose rregulloret përkatëse.

*Letra e Angazhimit të Auditimit ose Forma të Tjera Marrëveshjeje të Shkruar*¹⁶ (Ref: Para. 10-11)

A23. Është në interes si të entitetit ashtu edhe të audituesit që audituesi të dërgojë një letër angazhimi të auditimit para fillimit të auditimit për të ndihmuar në shmangien e keqkuptimeve në lidhje me auditimin. Megjithatë, në disa vende, objektivi dhe qëllimi i një auditimi dhe përgjegjësitë e drejtimit dhe ato të audituesit përcaktohen mjaftueshëm me ligj, që do të thotë që ato rekomandojnë çështjet që përshkruhen në paragrafin 10. Megjithëse në këto rrethana paragrafi 11 e lejon audituesin që të përfshijë në letrën e angazhimit vetëm referencë ndaj faktit që ligji apo rregulloret përkatëse janë zbatuar dhe që drejtimi pranon dhe kupton përgjegjësitë e tij ashtu siç përcaktohen në paragrafin 6(b), audituesi mundet megjithatë të konsiderojë të përshtatshme që të përfshijë në një letër angazhimi çështjet e përshkruara në paragrafin 10 për qëllime të informimit të drejtimit.

Forma dhe Përmbajtja e Letrës së Angazhimit të Auditimit

A24. Forma dhe përmbajtja e letrës së angazhimit të auditimit mund të ndryshojë për çdo entitet. Informacioni i përfshirë në letrën e angazhimit të auditimit mbi përgjegjësitë e audituesit mund të bazohet tek SNA 200.¹⁷ Paragrafët 6(b)

¹⁶Në paragrafët që vijojnë, çdo referencë ndaj një letre angazhimi auditimi duhet të merret si një referencë për një letër angazhimi auditimi apo formë tjetër e përshtatshme marrëveshjeje me shkrim.

¹⁷SNA 200, paragrafët 3-9.

dhe 12 të këtij SNA-je merren me përshkrimin e përgjegjësive të drejtimit. Përveç përfshirjes së çështjeve të kërkuara nga paragrafi 10, një letër angazhimi auditimi mund t'i referohet, për shembull:

- Shtjellimit të qëllimit të auditimit, duke përfshirë referencat ndaj legjislacionit të zbatueshëm, rregulloreve, SNA-ve dhe prononcimeve etike dhe të tjera të organizmave profesionale tek të cilat aderon audituesi.
- Formës së çdo komunikimi tjetër të rezultateve të angazhimit të auditimit.
- Kërkesave për audituesin për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit në pajtim me SNA 701.¹⁸
- Faktit që për shkak të kufizimeve të qenësishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e qenësishme të kontrollit të brendshëm, ekziston rreziku i pashmangshëm se disa anomali të rëndësishme nuk do të mund të zbulohen, edhe pse auditimi është planifikuar si duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.
- Përgatitjeve në lidhje me planifikimin dhe kryerjen e auditimit, përfshirë përbërjen e grupit të auditimit.
- Pritshmërisë se drejtimi do të sigurojë daklaratat me shkrim. (shiko gjithashtu paragrafin A13).
- Pritshmërisë që drejtimi do t'i japë audituesit akses tek të gjithë informacionet për të cilat ka dijeni se janë të lidhura me përgatitjen e pasqyrave financiare, përfshirë pritshmërinë që drejtimi do të japë akses edhe tek informacionet që lidhen me informacionet shpjeguese.
- Marrëveshjen që drejtimi të vërë në dispozicion të audituesit pasqyrat financiare paraprake dhe përfshirë të gjithë informacionet e tjera që lidhen me përgatitjen e tyre, pavarësisht nëse janë marrë nga brenda ose jashtë librave kontabël të përgjithshëm dhe ndihmës (përfshirë të gjitha informacionet që lidhen me përgatitjen e informacioneve shpjeguese), dhe informacionet e tjera¹⁹, nëse ka të tilla, në kohën e duhur me qëllim që të bëhet e mundur që audituesi të përfundojë auditimin në përputhje me afatet kohore të propozuara.
- Marrëveshjes që drejtimi të informojë audituesin për fakte që mund të ndikojnë pasqyrat financiare, për të cilat drejtimi mund të jetë i

¹⁸ SNA 701, *Komunikimi I Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

¹⁹ Sikurse përkufizohet në SNA 720 (I rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në lidhje me informacionet e tjera*

vetëdijshëm gjatë periudhës nga data e raportit të audituesit deri në datën që pasqyrat financiare publikohen.

- Bazës mbi të cilën llogaritentarifat dhe çdo marrëveshje faturimi.
- Një kërkesë për drejtimin që të konfirmojë marrjen e letrës së angazhimit të auditimit dhe të bjerë dakord për kushtet e angazhimit të përshkuara në të.

A25. Kur audituesi nuk është i detyruar të komunikojë çështjet kryesore të auditimit, mund të jetë e dobishme që ai t'ju referohet kushteve të angazhimit të auditimit, lidhur me mundësinë e komunikimit të çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit, dhe në disa juridiksione, mund të jetë e nevojshme që audituesi të përfshijë edhe një referencë për këtë mundësi, për të patur mundësinë që të veprojë në këtë mënyrë.

A26. Kur është e përshtatshme, pikat e mëposhtme mund të përfshihen gjithashtu në letrën e angazhimit të auditimit:

- Marrëveshjet në lidhje me përfshirjen e audituesve dhe ekspertëve të tjerë në disa aspekte të auditimit.
- Marrëveshjet në lidhje me përfshirjen e audituesve të brendshëm dhe stafit tjetër të entitetit.
- Marrëveshjet me audituesin e mëparshëm, nëse ka, në rastin e një auditimi fillestar.
- Një referencë dhe përshkrim të përgjegjësisive të audituesit sipas ligjit, rregullave dhe kërkesave përkatëse etike, që trajtojnë raportimin e papajtueshmërisë së identifikuar ose të dyshuar me ligjin dhe rregullat tek një autoritet i duhur jashtë entitetit.
- Ndonjë kufizim i përgjegjësisë së audituesit kur ekziston një mundësi e tillë.
- Një referencë për ndonjë marrëveshje të mëtejshme midis audituesit dhe entitetit.
- Ndonjë detyrim për të dhënë fletët e punës së auditimit palëve tjetra.

Një shembull i një letre angazhimi auditimi jepet në Shtojcën 1.

Auditimet e Entiteteve të Kontrolluara

A27. Kur audituesi i një entiteti mëmë është edhe audituesi i një entiteti të kontrolluar, faktorët që mund të ndikojnë në vendimin nëse do të dërgohet një letër e veçantë angazhimi auditimi për entitetin e kontrolluar përfshijnë:

- Kush e emëron audituesin e entitetit të kontrolluar;
- Nëse një raport i veçantë audituesi do të lëshohet për entitetin e kontrolluar;
- Kërkesat ligjore në lidhje me emërimet e auditimit;
- Shkalla e pronësisë nga mëma; dhe
- Shkalla e pavarësisë së drejtimit të entitetit të kontrolluar nga entiteti mëmë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Përcaktuara me Ligj ose Rregullore (Ref: Para. 11-12)

A28. Nëse, në rrethanat e përshkuara në paragrafët A22 dhe A27, audituesi arrin në përfundimin se nuk është e nevojshme të përfshihen disa kushte të caktuara të angazhimit të auditimit në një letër angazhimi auditimi, audituesi është ende i detyruar nga paragrafi 11 të kërkojë marrëveshjen me shkrim nga drejtimi ku ky i fundit pranon dhe kupton përgjegjësitë e përcaktuara në paragrafin 6(b). Megjithatë, në përputhje me paragrafin 12, një marrëveshje e tillë me shkrim mund të përdorë formulimin e ligjit ose rregullores nëse një ligj apo rregullore e tillë përcakton përgjegjësitë për drejtimin që kanë efekt ekuivalent me ato të përshkuara në paragrafin 6(b). Profesionit kontabël, hartuesi i standardeve të auditimit, ose rregullatori i auditimit në një juridiksion mund të ketë dhënë udhëzime nëse përshkrimi në ligj apo rregullore është ekuivalent.

Konsiderata të veçanta për entitetete sektorit publik

A29. Ligje ose rregullore që drejtojnë veprimtarinë e auditimeve në sektorin publik urdhërojnë në përgjithësi emërimin e një audituesi të sektorit publik dhe përcaktojnë zakonisht përgjegjësitë dhe kompetencat e tij, duke përfshirë të drejtën për të patur hyrje në të dhënat dhe informacione të tjeratë entitetit. Kur ligji ose rregullorja përshkruan në detaje të mjaftueshme kushtet e angazhimit të auditimit, audituesi i sektorit publik mundet megjithatë të marrë në konsideratë se ka përfitime në lëshimin e një letre angazhimi më të plotë se ajo që lejohet nga paragrafi 11.

Auditimet e Njëpasnjëshme (Ref: Para. 13)

A30. Audituesi mund të vendosë të mos dërgojë një letër të re angazhimit auditimi apo marrëveshje të tjera me shkrim çdo periudhë. Megjithatë, faktorët e mëposhtëm mund të bëjnë të nevojshme që të rishikohen kushtet e angazhimit të auditimit apo që të rikujtohet entiteti për kushtet ekzistuese:

- Çdo tregues që entiteti nuk kupton objektivin dhe qëllimin e auditimit.
- Çdo kusht i rishikuar apo i veçantë i angazhimit të auditimit.
- Një ndryshim i kohëve të fundit në drejtimin e lartë.
- Një ndryshim i rëndësishëm në pronësi.
- Një ndryshim i rëndësishëm në natyrën ose madhësinë e biznesit të entitetit.
- Një ndryshim në kërkesat ligjore ose rregullatore.
- Një ndryshim në kuadrin e raportimit financiar i zbatuar nëpërgatitjen e pasqyrave financiare.
- Një ndryshim në kërkesat e tjera të raportimit.

Pranimi i një ndryshimi në kushtet e angazhimit të auditimit

Kërkesë për të ndryshuar kushtet e angazhimit të auditimit (Ref: Para. 14)

A31. Një kërkesë nga ana e entitetit që audituesi të ndryshojë kushtet e angazhimit të auditimit mund të vijë si pasojë e një ndryshimi në rrethanat që ndikojnë në nevojën për shërbimin, një keqkuptimi në lidhje me natyrën e auditimit të kërkuar fillimisht ose një kufizimi në qëllimin e angazhimit të auditimit, qoftë ky i imponuar nga drejtimi apo i shkaktuar nga rrethana të tjera. Audituesi, siç kërkohet nga paragrafi 14, merr në konsideratë justifikimin e dhënë për kërkesën, dhe në veçanti pasojat e një kufizimi në qëllimin e angazhimit të auditimit.

A32. Një ndryshim në rrethana që ndikon kërkesat e entitetit ose një keqkuptim në lidhje me natyrën e shërbimit të kërkuar fillimisht mund të konsiderohet si një bazë e arsyeshme për të kërkuar një ndryshim në angazhimin e auditimit.

A33. Në të kundërt, një ndryshim nuk mund të konsiderohet i arsyeshëm nëse duket që ndryshimi është i lidhur me informacion të pasaktë, jo të plotë ose ndryshe të pakënaqshëm. Një shembull mund të jetë rasti kur audituesi nuk mund të

mbledhë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe entiteti kërkon që angazhimi i auditimit të ndryshohet në një angazhim rishikimi për të shmangur një opinion me rezervë ose refuzim të dhënies së opinionit.

Kërkesë për të Ndryshuar në një Rishikim ose në një Shërbim të Lidhur
(Ref: Para.15)

- A34. Para rënies dakord për të ndryshuar një angazhim auditimi në njëri shikim apo shërbim të lidhur, një auditues i cili ishte i angazhuar për të kryer auditimin në përputhje me SNA-të duhet të vlerësojë, përveç çështjeve të përmendura në paragrafët A29-A31 më sipër, çdo pasojë ligjore ose kontraktuale që sjell ky ndryshim.
- A35. Nëse audituesi arrin në përfundimin se ka një justifikim të arsyeshëm për të ndryshuar angazhimin e auditimit në një rishikim apo shërbim të lidhur, puna e auditimit e kryer deri në datën e ndryshimit mund të jetë e nevojshme për angazhimin e ndryshuar; megjithatë, puna që kërkohet të kryhet dhe raporti që do të lëshohet do të jenë ata që janë të përshtatshëm me angazhimin e rishikuar. Në mënyrë që të shmanget paqartësia e lexuesit, raporti mbi shërbimin e lidhur nuk do të përfshijë referencë të:
- (a) Angazhimit origjinal të auditimit; ose
 - (b) Çdo procedurë që mund të jetë kryer në angazhimin origjinal të auditimit, përveç rastit kur angazhimi i auditimit është ndryshuar në një angazhim me procedura të rena dakord dhe si rrjedhim referimi në procedurat e kryera është pjesë normale e raportit.

Konsiderata Shtesë në Pranimin e Angazhimit

Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të Plotësuaranga Ligji apo Rregulloret (Ref:Para. 18)

- A36. Në disa juridiksione, ligjet apo rregulloret mund të plotësojnë standardet e raportimit financiar të vendosura nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për hartimin dhe vendosjen e standardeve, me kërkesa shtesë në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare. Në këto juridiksione, kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar për qëllime të zbatimit të SNA-ve përfshinë bashku kuadrine raportimit financiar dhe kërkesa të tilla shtesë me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me kuadrin e identifikuar të raportimit financiar. Ky, për shembull, mund të jetë rasti kur ligji ose rregulloret përshkruajnë paraqitje përveç atyre që kërkohen nga standardet e raportimit financiar ose kur ato

kufizojnë gamën e zgjedhjeve të pranueshme që mund të bëhen brenda standardeve të raportimit financiar.²⁰

Kuadri i Raportimit Financiar i Përcaktuar me Ligj ose Rregullore-Çështje të Tjera që Ndikojnë Pranimin (Ref: Para. 19)

A37. Ligji apo rregulloret mund të përshkruajnë që formulimi i opinionit të audituesit të përdorë frazat "paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale" ose "japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë "në rastin kur audituesi arrin në përfundimin që kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar i përcaktuar me ligj ose rregullore do të kishte qenë përndryshe i papranueshëm. Në këtë rast, kushtet e formulimit të paracaktuar të raportit të audituesit janë shumë të ndryshme nga kërkesat e SNA-ve (shiko paragrafin 21).

Raporti i Audituesit i Përcaktuar me Ligj ose Rregullore (Ref:Para. 21)

A38. SNA-të kërkojnë që audituesi të mos deklarojë pajtim me SNA-të derisa audituesi të jetë në pajtim me të gjitha SNA-të e zbatuara për auditimin.²¹ Kur ligji ose rregulloret përcaktojnë paraqitjen ose formulimin e raportit të audituesit në një formë ose me kushte që janë shumë të ndryshme nga kërkesat e SNA-ve dhe audituesi arrin në përfundimin se keqkuptimet e mundshme nuk mund të zvogëlohen nëpërmjet shpjegimeve shtesë në raportin e audituesit, audituesi mund të marrë në konsideratë, të përfshijë në raportin e audituesit një deklaratë se auditimi nuk është kryer në përputhje me SNA-të. Megjithatë, audituesi është i inkurajuar të zbatojë SNA-të, përfshirë SNA-të që trajtojnë raportin e audituesit, deri në masën që kjo është e zbatueshme, pavarësisht se audituesit nuk i lejohej që të shprehet që auditimi është kryer në pajtim me SNA-të.

Konsiderata e Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A39. Kërkesa të veçanta mund të ekzistojnë në sektorin publik, brenda legjislacionit që udhëheq mandatin e auditimit, për shembull, audituesit mund t'i kërkohej që të raportojë drejtpërdrejt tek një ministër, ligjvënësi ose publiku, nëse entiteti bën përpjekje për të kufizuar qëllimin e auditimit.

²⁰SNA700 (i rishikuar), paragrafi 15, përfshin një kërkesë në lidhje me vlerësimin nëse pasqyrat financiare i referohen ose përshkruajnë në mënyrë të përshtatshme kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

²¹SNA 200, paragrafi 20.

Shtojca1

(Ref: Para. A24-26)

Shembull i një Letre të Angazhimit të Auditimit

Në vijim jepet një shembull i një letre të angazhimit të auditimit për një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithëshme të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo letër nuk është detyruese, por ka si qëllim të jetë vetëm një udhëzues që mund të përdoret në lidhje me përcaktimet e përshkruara në këtë SNA. Është e nevojshme që kjo letër të ndryshohet në varësi të kërkesave dhe rrethanave konkrete. Letra është hartuar për t'iu referuar auditimit të pasqyrat financiare për një periudhë të vetme raportimi dhe kërkon përshtatje nëse ka qëllim ose pritet të zbatohet për auditime të njëpasnjëshme (shiko paragrafin 13 të këtij SNA-je). Mund të jetë e nevojshme që të kërkohej këshillë ligjore nëse një letër e propozuar është e përshtatshme apo jo.

Drejtuar përfaqësues vetë duhur të drejtimit ose personave të ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë tregtare ABC:²²

[Objektivi dhe qëllimi i auditimit]

Ju²³ keni kërkuar që ne të auditojmë pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor, 20X1, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Kemi kënaqësinë që nëpërmjet kësaj letre t'ju konfirmojmë pranimin dhe marrjen përsipër të këtij angazhimi auditimi.

Objektivi i auditimit është të merret siguria e arsyeshme nëse pasqyrat financiare të marra në tërësi nuk kanë anomali materiale për shkak të mashtrimit ose të gabimit dhe të lëshohet një raport audituesi, që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNA), gjithnjë do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe ato konsiderohen materiale, nëse veças ose së bashku me anomali

²² Adresat dhe referencat në letër do të jenë ato që janë të përshtatshme për rrethanat e angazhimit, përfshirë edhe juridiksionin përkatës. Është e rëndësishme t'i referoheni personave të duhur – shiko paragrafin A22

²³ Gjatë gjithë kësaj letre, referencat për "ju", "ne", "neve", "menaxhimin", "personat e ngarkuar me qeverisjen" dhe "audituesi" do të përdoren ose të ndryshohen sipas rrethanave.

të tjera, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e pasqyrave financiare.

[Përgjegjësitë e audituesit]

Auditimin do ta kryejmë në përputhje me (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu do të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, nga mashtrimi apo nga gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që ju përgjigjen këtyre rreziqeve dhe do të sigurojmë evidencën e auditimit, të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rrjedh nga mashtrimi është më i lartë se rreziku i një anomalie që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë fshehjen, falsifikimin, mungesat e qëllimshme, keq paraqitjet, ose shmangiet e kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë njohjen për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, me qëllim që të hartojmë procedurat e auditimit të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.²⁴ Megjithatë, ne do të komunikojmë me ju me shkrim, për ndonjë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat i kemi identifikuar gjatë auditimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël, si dhe informacionet përkatëse shpjeguese, të bëra nga drejtimi dhe paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguar, do të vlerësojmë, nëse ka ndonjë pasiguri materiale për ngjarjet ose kushte, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha në lidhje me aftësitë e shoqërisë tregtare për të vazhduar aktivitetin në vijimësi. Nëse ne arrijmë në përfundimin se ka një pasiguri materiale të madhe, jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për informacionet përkatëse shpjeguese në pasqyrat financiare, ose nëse këto informacione nuk janë të mjaftueshme, për të modifikuar opinionin. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të siguar deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të mos e vijojë në vazhdimësi aktivitetin e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese dhe, nëse pasqyrat financiare

²⁴Kjo fjali do të modifikohet, sipas rastit, kur audituesika edhe përgjegjësi të lëshojë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.

paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në një mënyre të atillë që arrihet paraqitja e drejtë. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pamënjanueshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar sic duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.

[Përgjegjësitë e drejtimit dhe identifikimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar (për qëllime të këtij shembulli supozohet se audituesi nuk ka përcaktuar se ligji ose rregulloret paraqesin këto përgjegjësi në kushte të përshtatshme; përshkrimet në paragrafin 6(b) të kësaj SNA-je përdoren për këtë arsye)].

Auditimi ynë do të kryhet duke u bazuar në faktin që [drejtimi dhe, kur është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen]²⁵ pranojnë dhe kuptojnë se ata kanë përgjegjësi:

- (a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;²⁶
- (b) Për kontrolle të brendshme të tilla që [drejtimi] i konsideron si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga mashtrimi ashtu edhe nga gabimi; dhe
- (c) T'i japin audituesit²⁷:
 - (i) Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat [drejtimi] është në dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - (ii) Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga [drejtimi] për qëllime të auditimit;dhe
 - (iii) Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda entitetit nga të cilët gjykohet e nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë [nga drejtimi dhe, kur është e përshtatshme, nga personat engarkuar me qeverisjen] që të marrim prej tij konfirmim e me shkrim lidhur me paraqitjet që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

Shpresojmë të kemi bashkëpunim të plotë me stafin tuaj gjatë auditimit tonë.

²⁵Përdorimi i terminologjisës së përshtatshme sipas rrethanave.

²⁶Ose, nëse është e përshtatshme, "Për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. "

²⁷Për shembuj të çështjeve të tjera që mund të përfshihen, të cilat lidhen me përgjegjësitë e drejtimit shiko paragrafin A23.

RËNIA DAKORD ME KUSHTET E ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

[Informacione të tjera të nevojshme]

[Përfshihen informacione shtesë, të tilla si marrëveshjet e honorareve të pagesave, faturimet dhe kushte të tjera specifike, sipas rastit].

[Raportimi]

[Përfshihen referencat e përshatshme lidhur me formën dhe përmbajtjen e pritshme të raportit të audituesit, përfshirë, nëse është rasti, raportimin mbi informacionet e tjera në pajtim me SNA 720 (i rishikuar)]

Forma dhe përmbajtja e raportit tonë mund të ketë nevojë të ndryshohet në sajë të gjetjeve të auditimit tonë.

Ju lutemi firmoseni dhe na dërgoni kopjen që i bashkëngjitet kësaj letre për të treguar pranimin nga ana juaj, dhe rënien dakord për auditimin e pasqyrave financiare duke përfshirë përgjegjësitë tona reciproke.

XYZ & Co.

Pranuar dhe rënë dakord në emër të Shoqërisë ABC nga

(firmosur)

.....

Emri dhe Titulli

Data

Përcaktimi i Pranueshmërisë së Kuadrove për Qëllime të Përgjithshme**Juridiksionet që Nuk Kanë Organizata të Autorizuara apo të Njohura për Vendosijen e Standardeve ose Kuadro të Raportimit Financiar të Përcaktuar me Ligj ose Rregullore**

- a. Siç shpjegohet në paragrafin A10 të këtij SNA-je, kur një entitet është i regjistruar ose vepron në një juridiksion që nuk ka një organizatë të autorizuar ose të njohur për vendosjen e standardeve, ose kur përdorimi i kuadrit të raportimit financiar nuk është i përcaktuar me ligj ose rregullore, drejtimi identifikon një kuadër të zbatueshëm raportimi financiar. Praktikanë juridiksione të tilla është shpesh përdorimi i standardeve të raportimit financiar të përcaktuar nga një nga organizatat e përshkruara në paragrafin A8 të këtij SNA-je.
- b. Në mënyrë alternative, në një juridiksion të veçantë mund të jenë përcaktuar marrëveshje kontabël, që janë të njohura në përgjithësi si kuadër raportimi financiar për pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të përgatitura nga entitete të caktuara të specifikuar që veprojnë në atë juridiksion. Kur zbatohet një kuadër i tillë raportimi financiar, audituesit i kërkohet nga paragrafi 6(a) i këtij SNA-je që të përcaktojnë nëse konventat e kontabilitetit të marra sëbashku mund të konsiderohen se përbëjnë një kuadër të raportimit financiar të pranueshëm për pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme. Kur konventat e kontabilitetit janë të përdorura gjerësisht në një juridiksion të veçantë, profesioni kontabël në atë juridiksion mund të ketë marrë parasysh pranueshmërinë e kuadrit të raportimit financiar për llogari të audituesve. Si alternativë, audituesi mund ta bëjë këtë përcaktim duke marrë parasysh nëse konventat kontabël shfaqin tiparet që normalishtshfaqen nga kuadrote pranueshmetë raportimit financiar (shiko paragrafin 3 më poshtë), ose duke krahasuar konventat e kontabilitetit me kërkesat e një kuadri ekzistues të raportimit financiar që konsiderohet të jetë i pranueshëm. (shiko paragrafin 4 më poshtë).
- c. Kuadri i pranueshëm i raportimit financiar shfaq normalisht tiparet në vijim që rezultojnë në informacion të dhënë në pasqyrat financiare që është i dobishëm për përdoruesit e synuar:
 - (a) Përkatësia, nëse informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare është i rëndësishëm për natyrën e entitetit dhe qëllimin e pasqyrave financiare. Për shembull, në rastin e një sipërmarrje biznesi që përgatit pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme, rëndësia vlerësohet në aspektin e informacionit të nevojshëm për të plotësuar nevojat e zakonshme për informacion financiar në marrjen e vendimeve ekonomike të një game të gjerë përdoruesish. Këto nevoja plotësohen zakonisht duke paraqitur

- pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë së sipërmarrjes së biznesit.
- (b) Plotësia, në kuptimin që transaksionet dhe ngjarjet, llogaritë bankare dhe paraqitjet që mund të ndikojnë në konkluzionet e bazuara në pasqyrat financiare nuk janë përjashtuar.
- (c) Besueshmëria, në kuptimin që informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare:
- (i) Kur është e mundur, pasqyron thelbin ekonomik të ngjarjeve dhe transaksioneve dhe jo thjesht formën e tyre ligjore; dhe
 - (ii) Rezulton në vlerësim, matje, paraqitje dhe informim të qëndrueshëm dhe të arsyeshëm, kur përdoret në rrethana të ngjashme.
- (d) Neutraliteti, në kuptimin që jep kontributqë informacioni në pasqyrat financiare të jetë i lirë nga paragjykimet.
- (e) Kuptueshmëria, në kuptimin që informacioni në pasqyrat financiare është i qartë dhe gjithëpërfshirës dhe nuk është subjekt i interpretimeve shumë të ndryshme.
- d. Audituesi mund të vendosë të krahasojë konventat e kontabilitetit me kërkesat e një kuadri ekzistues të raportimit financiar që konsiderohet të jetë i pranueshëm. Për shembull, audituesi mund të krahasojë konventat e kontabilitetit me SNRF-të. Për një auditim të një entiteti të vogël, audituesi mund të vendosë të krahasojë konventat e kontabilitetit me një kuadër raportimi financiar të zhvilluar në mënyrë specifike për entitete të tilla nga një organizatë e autorizuar ose e njohur përvendosjen e standardeve. Kur audituesi bën krahasime të tilla dhe identifikon diferenca, vendimi nëse konventat e kontabilitetit të miratuara për përgatitjen e pasqyrave financiare përbëjnë një kuadër të pranueshëm raportimi financiar përfshin marrjen parasysh të arsyeve të diferencave dhe faktin nëse aplikimi i konventave të kontabilitetit, ose përshkrimi i kuadrit të raportimit financiar në pasqyrat financiare, mund të rezultojë në pasqyra financiare keqinformuese.
- e. Një përzierje e konventave të kontabilitetit hartuar për t'iu përshtatur preferencave individuale nuk është një kuadër i pranueshëm raportimi financiar për pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme. Në mënyrë të ngjashme, një kuadër pajtueshmërie nuk do të jetë një kuadër i pranueshëm raportimi financiar, nëse nuk është pranuar gjerësisht në juridiksione të veçanta nga përgatitësit dhe përdoruesit.